



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-052

Prishtinë, më 16 shkurt 2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 16 SHKURT 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Slobodan Petroviq dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri dhe Slavko Simiq.

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj,

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati dhe

Nga KDI-ja: Albert Krasniqi.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Në fillim të mbledhjes, kryetari i dëshiroi mirëseardhje nënkryetarit të Kuvendit nga radha e komunitetit turk, z. Fikrim Damka, i cili e zëvendësoi nënkryetaren e deritanishme, znj. Duda Balje

Pastaj, kryetari i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 16 janar 2016.
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 22 janar 2016

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 22 janar 2016.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i GP të LDK-së, z. Ismet Beqiri, propozoi që Kuvendi të mbajë një seancë solemne më 17 shkurt 2016, për shënimin e 17 Shkurtit 2008 - Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Lidhur me propozimin e kryetarit të GP të LDK-së, z. Ismet Beqiri, diskutuan: Adem Grabovci, Xhavit Haliti, Aida Dërguti, Fikrim Damka, Slobodan Petroviq dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve lidhur me propozimin e lartcekur, kryetari tha se për shkak të rrethanave politike të krijuara Kuvendi nuk do të mbajë seancë solemne.

* * *

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet për seancë plenare, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të pranishme në mbledhje, me shumicë votash, (5 “për” dhe 1 “kundër” - Aida Dërguti), vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të premten, më 19 shkurt 2016, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068,*

5. *Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10,*
6. *Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2014 për projektin e huas,*
7. *Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë Kosovë - UniCredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në QKUK,*
8. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit,*
9. *Votimi i propozim-amendamentit nr. 25 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i riproceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës,*
10. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës,*
11. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve,*
12. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara,*
13. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet strategjike në Republikën e Kosovës,*
14. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kundërvajtje,*
15. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit,*
16. *Shqyrtimi i propozim-Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij,*
17. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për standardizimin,*
18. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë,*
19. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Bujqësor,*
20. *Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2016,*
21. *Zgjedhja e një (1) anëtari në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe*
22. *Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.*

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave:

1. *Rekomandimi i Komisionit ad hoc për ri-shpalljen e konkursit për anëtarë të Bordit për Ankesa të Medieve*

Kryesia, pasi e shqyrtoi rekomandimin e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Të rishpallet konkursi për zgjedhjen e tre (3) anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve.

2. Administrata e Kuvendit ngarkohet që në bazë të dispozitave të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Medieve ta rishpallë konkursin për tre (3) anëtarë të Bordit për Ankesa të Medieve.

2. Rekomandimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për përzgjedhjen e kompanisë për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitet 2015, 2016 dhe 2017

Kryesia, pasi e shqyrtoi rekomandimin e lartshënuar, nxori këtë:

PËRFUNDIM

1. Autorizohet Administratën e Kuvendit, përkatësisht Drejtoria e Prokurimit që të bëjë përzgjedhjen e Auditorit të Jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitet 2015, 2016 dhe 2017.

2. Pas përzgjedhjes së kompanisë audituese, Drejtoria e Prokurimit duhet ta njoftojë me shkrim Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

3. Pas përfundimit të procedurave, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike duhet ta njoftojë me një raport me shkrim Kryesinë e Kuvendit për përzgjedhjen e Auditorit të Jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitet 2015, 2016 dhe 2017.

3. Kërkesa për emërimin e kryetarëve dhe nënkryetarëve të grupeve të miqësisë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, i emëroi kryetarët dhe zëvendëskryetarët e grupeve të miqësisë nga radha e grupeve parlamentare, sipas vendimit të miratuar në mbledhjen e mbajtur më 20 tetor 2015. Ndërsa, për ato grupe të miqësisë që nuk ishin propozuar kryetarët dhe zëvendëskryetarët, u kërkua nga grupet parlamentare që t'i propozojnë deputetët për ato pozita, me qëllim të funksionalizimit të grupeve të miqësisë me parlamentet e shteteve të tjera.

4. Kërkesa e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financa Publike për auditimin e raporteve financiare dhe raportit të deklarimit financiar të fushatës të cilat dorëzohen nga subjektet politike në KQZ për vitet 2013, 2014 dhe 2015

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

PËRFUNDIM

1. Ngarkohet Administrata e Kuvendit, përkatësisht Drejtoria e Prokurimit që t'i ndër marrë veprimet e nevojshme për të bërë thirrje të hapur për aplikim për përzgjedhjen e së paku 10 auditorëve të licencuar, të cilët do t'i auditojnë raportet financiare dhe raportet e deklarimit financiar të fushatës, të cilat dorëzohen nga subjektet politike në KQZ për vitet 2013, 2014 dhe 2015.

2. Mjetet buxhetore për përmbushjen e obligimit, të cekur në paragrafin 1 (një) të këtij përfundimi, i bart Kuvendi i Republikës së Kosovës.

5. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve me rastin e vizitës në Kosovë të z. Shemsudin Mehmedoviq, kryetar i Komisionit për Tregti të Jashtme dhe Doganë të Asamblesë Parlamentare të Bosnjës dhe Hercegovinës, prej 23 -24 shkurt 2016,

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Miratohet kërkesa që z. Shemsudin Mehmedoviq, kryetar i Komisionit për Tregti të Jashtme dhe Doganë të Parlamentit të Bosnjës dhe Hercegovinës, ta vizitojë Kuvendin e Republikës së Kosovës, prej 23-24 shkurt 2016.

2. Të gjitha shpenzimet lidhur me vizitën e kryetarit të komisionit të cekur në paragrafin 1 (një) të këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

6. Njoftimi për ndërrimin e nënkryetarit të Kuvendit nga radha e komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë, sipas marrëveshjes së tyre dhe vendimit të Kuvendit nr. 05-V-003, të datës 8 dhjetor 2014,

Kryesia u njoftua me marrëveshjen e Grupit Parlamentar “6+” dhe me vendimin e Kuvendit se pas përfundimit të mandatit të nënkryetares së Kuvendit, znj. Duda Balje, më 7 shkurt 2016, me rotacion zgjidhet deputeti nga komuniteti turk, z. Fikrim Damka, prej 8 shkurt 2016 deri më 8 prill 2017.

7. Njoftimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me rekomandimin për transferin e mjeteve buxhetore për Radiotelevizionin e Kosovës për periudhën 1 janar - 31 mars 2016.

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, i cili i ka rekomanduar Ministrisë së Financave transferin e mjeteve buxhetore nga llogaria e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës në llogarinë e Radiotelevizionit të Kosovës, kategoria ekonomike, subvencione dhe transfere, për periudhën 1 janar - 31 mars 2016, në shumën prej 2,400,000 (dy milionë e katërqind mijë) euro.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 12:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale